



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 15 shkurt 2012, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Liburn Aliu, Sasha Gjokiq, dhe Flora Brovina.

Munguan: Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF; Ervin Ibrahim- UNDP; Fadil Racaj- MPMS.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 31.01. 2012 dhe 06.02.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve;**
- 5. Formimi i grupit të punës për monitorimin e një ligji;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 11.01. 2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale, pa vërejtje i miratoi procesverbalet e datës 31.01 2012 dhe atë të datës 06.2.2012.

Me propozimin e kryesuesit, u vendos që pika e katërt e rendit të ditës të shqyrtohet para pikës së tretë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve

Fikrim Damka- Tha se sot e kemi prezent Fadil Racajn nga MPMS-ja, i cili do të na jepë shpjegime shtesë rreth këtij Projektligji.

Fadil Rracaj- Ne mendojmë që neni 4 i Projektligjit duhet të hiqet në tërësi, për arsye se nuk është marrë parasysh një konventë për organizimin e shërbimeve të punësimit dhe organizimi dhe funksionimi i institucioneve të punësimit duhet të organizohet me një ligj të veçantë. Mendojmë se ky Projektligj do të jetë në programin legjislativ për vitin 2013. Shërbimet publike të punësimit i përfshijnë edhe zyrat e punësimit edhe zyrat rajonale të punësimit. Nëse ju vendosni ta hiqni këtë nen, atëherë duhet të bëhet një përkufizim më i saktë i këtyre zyrave.

Liburn Aliu- Deklaroi se pajtohet që të hiqet struktura organizative, por duhet të definojmë kompetencat e zyrave të punësimit dhe zyrave rajonale të punësimit dhe të bëhet i qartë dallimi në mes këtyre dy zyrave. Patjetër duhet të definohet përmes këtij Ligji marrëdhënia në mes këtyre dy subjekteve. Ligji duhet të ketë rrjedhojë logjike. Te Projektligj për skemën sociale, përmendet një nga kriteret që ka të bëjë me atë se i papunësuar duhet të bëjë një kontratë me zyrën e punësimit, ndërkaq në Projektligjin për evidencën e të papunëve dhe punëkërkuesve, nuk specifikohet një gjë e tillë. Duhet të bëhet një harmonizim ndërmjet këtyre dy projektligjeve.

Flora Brovina- Nëse e heqim këtë nen, duhet të kemi një propozim që rregullon dhe qartëson rolin e këtyre zyrave.

Nazane Breca- Tha se do të ishte mirë që të hartohej një propozim për këto ndryshime nga Ministria.

Fadil Racaj- Tha se duhet të bëhet një harmonizim më i mirë ndërmjet këtyre dy projektligjeve. Do të ishte mirë që ta kemi një takim të përbashkët për këto dy projektligje.

Pas diskutimeve, Komisioni u dakordua që t'i organizojë dy takime. Njëri takim për harmonizimin e Projektligjit për evidencën e të papunëve dhe punëkërkuesve dhe Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e asistencës sociale,

ndërsa takimi tjetër do të jetë rreth Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e asistencës sociale.

3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare

Fikrim Damka- Tha se i kemi përfunduar amendamentet për këtë Projektligj dhe të gjitha komisionet kryesore i kanë pranuar amendamentet tona, përveç dy amendamenteve, të cilat nuk janë përkrahur nga Komisioni për Legjislacion. Sot, ne do të vendosim që t'i tërheqim amendamentet që nuk përkrahen nga ky Komision apo t'i dërgojmë në seancë.

Liburn Aliu- Deklaroi se përkrah idenë që këto amendamente t'i dërgojmë në seancë dhe seanca të vendosë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri vendos ta miratojë Raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare.

5. Formimi i grupit të punës për monitorimin e një ligji

Fikrim Damka- Sipas Planit të punës, ne duhet ta monitorojmë një ligj për këtë sesion. Propozoj ta marrim për monitorim Ligjin e punës.

Komisioni vendosi që për sesionin pranveror ta monitorojë Ligjin e punës.

6. Të ndryshme

Nazane Breca- I njoftoi anëtarët e Komisionit që është zhvilluar një takim i grupit të punës për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e asistencës sociale. Në emër të grupit të punës, propozoi që për ekspert rreth këtij Projektligji ta angazhojë Armend Shkozën.

Salihe Mustafa- E propozoi Mursel Zyberin.

Liburn Aliu- Tha se, së pari në grupin e punës kam propozuar Armend Shkozën, duke pasur për bazë punën e tij, të cilën kam pasur rastin ta shoh.

Komisioni me shumicë votash vendosi që si ekspert për këtë Projektligj ta angazhojë Mursel Zyberin.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka